REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.499 Prot

Maliq, më 02.02.2026

VENDIM
Nr. 17, datë 30.01.2026

PËR
"PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E QIRASË SOCIALE PËR FAMILJET E STREHUARA NË BANESËN SOCIALE "ISH LABORATORI"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 24 "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale" neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*", gërma "f" ku thuhet se: "*vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi*", ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, me ligjin nr. 48/2023nr.139/2015, neni 33 pika 20 ku thuhet se: "*Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira*", VKB nr.57 datë 25.08.2021 "*Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimin e tyre në godinën e Ish Laboratorit Qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore*" si dhe VKB nr.58 datë 25.08.2021 "*Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Ish Kombinatit të Sheqerit Maliq*", Këshillit i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga pagesa e qirasë për vitin 2026 e në vazhdim, deri në një vendim të dytë, për familjet e strehuara në Banesën Sociale "Ish Laboratori, si më poshtë. Familjet e strehuara në BSQ Ish Laboratori

Nr	Emër, atësia, mbiemër	Kategoria
1.	Edmond Haxhi Pero	Egjiptian
2.	Esat Riza Marjanaku	NE/Pension
3.	Piro Astrit Mete	Egjiptian
4.	Dorjan Hysen Terolli	Egjiptian
5.	Françesko Astrit Mete	Egjiptian/NE
6.	Shpëtim Selim Sulejmani	NE/Rom
7.	Erion Nazmi Rexha	Rom
8.	Natasha Adem Stoceni	Pak/Rom

2. Të falë detyrimet e prapambetura nga qiraja e papaguar gjatë viteve të kaluara për këto familje.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Strehimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar .

Miratuar me 22 vota
Vota Pro 22
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI